



DRTK SHKODËR
SEKTORI I AAAMTK

MIRATOHET
Sekretari i KKTKM
Joli Mitrojorgji

RELACION TEKNIK

PROJEKT RESTAURIMI **OBJEKT : MUZEU KOMBETAR I FOTOGRAFISE “MARUBI”**



MARS 2025

PËRMBAJTJA :

<i>Hyrje</i>	<i>3</i>
<i>Vendodhja</i>	<i>.4</i>
<i>Të dhëna historike dhe përshkrimi arkitektonik</i>	<i>5</i>
<i>Gjendja aktuale</i>	<i>8</i>
<i>Problematika dhe ndërhyrje.....</i>	<i>11</i>
<i>Bibliografia</i>	<i>13</i>

HYRJE

Objekti këtij projekti restaurimi është në pronesi të Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkoder.

Hartimi i projektit fillon me kërkimin historik, konsultimi i materialeve historike, studimi i ndërhyrjeve restauruese të mëparshme, studimi i rilevimeve ndër vite etj. Kjo fazë është e rëndësishme për të ndërtuar kronologjinë historike të objektit, dokumentimin e ndërhyrjeve restauruese, si dhe evidentimin e zonave ku ka ende vend për ndërhyrje në projektet e tjera. Puna kërkimore është pasuar nga rilevimi fotografik, rilevimi gjeometrik duke bërë të gjitha matjet e nevojshme për të kaluar pastaj tek rilevimi arkitektonik.

Rilevimi gjeometrik ndihmon në vizatimin e saktë të fragmenteve të planimetrive; tipologjinë dhe karakteristikat ndërtimore. Një rilevim arkitektonik i kujdesshëm dhe evidentim sa më i detajuar i degradimeve do ndihmojë për hartimin e një projekti restaurimi sa më të plotë.

Materiali është i organizuar si më poshtë: pjesa që i përket studimit historik të objektit, përshkrimi arkitektonik, për të vazhduar me problematikat, ndërhyrjet, specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

VENDODHJA

Objekti është pjesë e ansamblit arkitektonik-urbanistik të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, miratuar me Vendim nr.771, datë 30.09.2020 “Për deklarinimin Pasuri Kulturore e Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, për caktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.



Fig 1. Harta e Shqipërisë, evidentimi i qarkut Shkoder




Fig 2. Ortofoto


TE DHENAT HISTORIKE

Shkodra është qytet dhe bashki në Shqipërinë veri-perëndimore si dhe është qendra e qarkut me të njëjtin emër. Është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë, me një histori banimi mijëvjeçare në qytet dhe krahinë.

I çmuar ndërkohëra të ndryshme si nyjë me rëndësi gjeostrategjike prej afërsisë mes malësive, liqenit, detit dhe rrugëve me rëndësi në kuadrin e Ballkanit Perëndimor.

Toponimia e qytetit shtrihet në aq shtresa sa ç'është e gjurmueshme historia e rishtë e tij, duke pasur shtresëzime që dëshmojnë periudhën latine, sllave, osmane, mbivendosjet e emërtimeve nga regjimi komunist apo edhe toponi me të reja. Kodrat rreth të cilave shtrihej qyteti në kohën e Barletit quheshin *Kazenë*, *Valdunus* (kodra e kalasë) dhe *Zarufe*.

Objekti në pronesi të Lulash Murrizi ndodhet në Rr. “Gjuhadol”. Ajo ruan vlera të papërsëritshme historike, urbanistike, arkitektonike dhe artistike të periudhës së fund shek. XIX dhe fillim shek. XX.



PERSHKRIMI ARKITEKTONIK

Godina e Fototekës "Marubi" është pjesë e kompleksit të rrugës "Gjuhadol", e ndodhur në rrugën "Kol Idromeno". Fasada e saj, e ndërtuar me gurë të latuar, është një dialog mes së kaluarës dhe së tashmes, ku hijeshia tradicionale ndërthuret me një elegancë të përjetshme.

Struktura e objektit është simetrike dhe harmonike, duke pasqyruar tiparet e arkitekturës klasike shkodrane me ndikime të lehta neoklasike. Kati përdhe dominohet nga tre harqe të mëdha, të theksuara me gurë në ngjyrë më të çelët, që i japin fasadës një ritëm të veçantë. Dyert e drurit janë në formën e vetratave të mëdha me xham transparent, që lejon të sodisesh që nga jashtë ambientet. Kati i sipërm ka dritare drejtkëndore të pajisura me grila druri, një detaj që kujton fasadat tradicionale të qytetit. Kontrasti mes gurit të ftohtë dhe drurit të ngrohtë sjell një ekuilibër të përsosur vizual, duke e bërë ndërtesën të duket si një kujdestare e kohës, e palëkundur nga dekadat. Mbi fasadë, një çati e mbuluar me tjegulla të kuqërremta kompletton harmoninë e strukturës, duke e lidhur me peizazhin arkitektonik të qytetit. Dy flamuj – ai kombëtar dhe ai institucional – valëviten butësisht në erë, duke i dhënë ndërtesës një frymë solemniteti dhe krenarie.

Hapësira përreth saj është e gjallë, me stolat dhe elementët urbanë të vendosur me kujdes, duke krijuar një ndjesi pritjeje dhe mikpritjeje për vizitorët që vijnë për të zbuluar thesaret e fotografisë shqiptare. Fototeka Marubi nuk është thjesht një ndërtesë, por një monument i kujtesës, ku arkitektura bëhet vetë një kornizë për historinë që ruhet brenda saj.



Fig 5. Foto e baneses marre nga ambjentet e jasht

Gjendja aktuale

Nw twrws i objekti ruhet nw gjendje t w mirw. Tw gjith e elemntet jane te ruajtura me kujdes. Ndwrhryrja do te konstatoj ne zmadhimin e nje siperfaqeje qe do te riformulohet ne funksion te krijimit te hapësirave per coworking.

Foto te gjendjes ekzistuese




Fig 6, 7. Foto te brendshme

Problematika dhe ndërhyrje

Nderhyrjet e propozuara jane emergjente ne funksion te riformulimit te ambjenteve te brendshme:

- 1 Prishje mur tulle me pastrim
- 2 Çmontim dyer dritare
- 3 Mur me tulla të lehtësuara dopio - 3m, llaç gelqere 1:3
- 4 Suva brenda mur tulle me krah, llaç gëlqere 1:2
- 5 Tavan I varur me pllka gipsi 60x60cm
- 6 Shtrese me pllaka porcelanat
- 7 Sistemi elektrik
- 8 Sistemi I kondicionimit

Bibliografia

Revista Monumentet, Shpresa Prifti

Hamdi Bushati : Shkodra dhe motet v.II f.153, Shkoder 1999, "Idromeno".

Punoi:

Sabrina Kuci

Fatjon Mlloja

Elson Laqja

Jozel Radovani

Miratoi:

Petrit Bilali, Pergj Sektori AAAMTK



Digitally signed by
Sabrina Kuci
Date: 2025.03.20
09:47:55 +02'00'

Fatjon
Mlloja

Digitally signed by
Fatjon Mlloja
Date: 2025.03.20
10:00:10 +02'00'

Drejtore
Amila Gjyrezi
Petrit Bilali

Digitally signed by
Petrit Bilali
Date: 2025.03.20
10:29:19 +02'00'

Amila
Gjyrezi

Digitally signed by
Amila Gjyrezi
Date: 2025.03.26
16:10:02 +02'00'

Joli
Mitrojorgji

Digitally signed by
Joli Mitrojorgji
Date: 2025.05.07
17:21:23 +02'00'